



Tiranë, më 10 Qershor 2020

## NDAL DHUNËS SEKSUALE NDAJ VAJZAVE DHE GRAVE!

**Kërkesë Publike e Rrjetit të Monitorimit  
kundër Dhunës me Bazë Gjinore për reflektim serioz të  
institucioneve dhe marrjen e disa masave urgjente**

### **Drejtuar:**

- Z. Gramoz Ruçi, Kryetar, Kuvendi i Shqipërisë
- Znj. Naureda Llagami, Kryetare, Këshilli i Lartë Gjyqësor,
- Z. Gentian Ibrahim, Kryetar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,
- Z. Sandër Lleshaj, Ministër, Ministria e Brendshme
- Znj. Besa Shahini, Ministre, Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë
- Znj. Ogerta Manastirliu, Ministre, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Znj. Etilda Gjonaj, Ministër, Ministria e Drejtësisë
- Z. Ardi Veliu, Drejtor, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Z. Besnik Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Znj. Alma Tandili, Kryetare, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- Z. Gentian Sala, Kryetar, Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA
- Zj. Valbona Treska, Presidente, Urdhri i Psikologut

Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore i përbërë nga 48 organizata të shoqërisë civile<sup>1</sup> ka ndjekur me shqetësim të thellë, rastet e fundit të bëra publike në media, të dhunës seksuale ndaj vajzave të mitura, të cilat tronditën mbarë opinionin publik. Secili nga këto raste ka veçoritë e tij, por megjithatë Rrjeti vëren se:

1. Këto raste mund të ishin parandaluar. Por, rrjeti vëren se strukturat shtetërore të referimit të dhunës seksuale nuk kanë trajtuar me përgjegjshmëri dhe seriozitet çdo kallëzim apo sinjalizim që kanë marrë në rrugë të ndryshme për dhunën seksuale ndaj vajzave, Ato, me nismën e tyre, nuk kanë qënë proaktive në identifikimin dhe zbulimin e këtyre rasteve. Qytetarët, kanë heshtur dhe nuk kanë reaguar. Familja nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur interesit më të lartë të fëmijës dhe problemeve të të miturve.
2. Modeli “Shkolla - Qendër Komunitare” nuk po funksionon dhe nuk po shohim përfshirjen e komunitetit në shkolla. Shkollat dëshmojnë të jenë të mbyllura ndaj informacionit që duhet t’u jepet nxënësve për fenomenin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, mjetet ligjore dhe mekanizmat ekzistues për parandalimin, mbrojtjen dhe referimin e rasteve të dhunës, kur ato ndodhin. Kurrikula e psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla apo e psikologëve klinikë ka mangësi në trajtimin e temave mbi fenomenin e dhunës seksuale. Trajnime të vazhdueshme mbi trajtimin e çështjeve të dhunës dhe dhunës ndaj të miturve janë të nevojshme për psikologët e shkollave. Rrjeti vëren se është i domosdoshëm vijimi i trajnimeve për mësuesit, diskutimet me prindërit e kujdestarët ligjorë për këto tema dhe edukimi seksual në shkolla. Bordet e prindërve dhe të nxënësve në shkolla janë shpesh joefektive dhe kanë mungesë transparence. Shkollat po shndërrohen në institucione të pasigurta për fëmijët dhe vendosja e oficerëve të sigurisë në shkolla nuk e shtoi sigurinë në shkolla sepse shpesh komuniteti dhe shkolla shihen si të ndara nga njeri-tjetri.
3. Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla, por edhe cilësia e ofrimit të mbështetjes psiko-sociale është e pamjaftueshme për t’ju përgjigjur nevojave të nxënësve dhe për të mundur identifikimin dhe adresimin në kohë të rasteve të dhunës seksuale ndaj vajzave.
4. Organet e Policisë së Shtetit operojnë kryesisht vetëm mbi bazë të ankesave dhe mungojnë iniciativat e tyre pro-aktive për parandalimin dhe zbulimin e rasteve të dhunës seksuale ndaj të miturve. Për më tepër, rasti i raportuar në media nga vajza e dhunuar seksualisht në Shtëpinë e Fëmijës-Shkodër evidentoi në mënyrë shqetësuese ri-viktimizimin, referuar akuzave për dhunë seksuale që rëndojnë ndaj punonjësit të policisë, tek i cili kërkoi ndihmë kundër abuzuesit të saj.
5. Ka ardhur koha për rishikimin e mekanizmave të monitorimit dhe marrjen e masave për monitorim në vazhdimësi të çdo rasti të referuar “follow up”. Për rastet që kanë probleme sigurie duhet garantuar mbikqyrje të afërt ose monitorim me anë të paisjeve dhe sistemeve të sigurisë të montuar në trup për

<sup>1</sup> <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/anetare-te-rrjetit-rw-obj-ve-per-monitorimin-e-zbatimit-te-standarteve-kunder-dhbgj-dhe-dhf/>

dedektim të lëvizjeve dhe me mundësi përgjimi audio në 24 orë (këto sisteme mund të aplikohen si masa të caktuara nga Gjykata në Urdhrit e Mbrojtjes, por me njohje dhe pranim vullnetar të dhunuesit edhe pas përfundimit të efekteve të urdhrit të mbrojtjes).

6. Rrjeti vëren se mungojnë politika të qarta në lidhje me detyrimin e punonjësve të policisë për të mos ushtruar ngacmime seksuale edhe në marrëdhëniet e policisë me të tretët. Zbatimi i procedurave standarde të veprimit, rregulloreve dhe kodit të etikës ka nevojë të forcohet. Rastet e bërjes përgjegjës të punonjësve të policisë që kanë kryer veprime në kundërshtim me to janë të pakta dhe nuk bëhen objekt diskutimi për të parandaluar përsëritjen e tyre. Në ambientet e strukturave vendore të policisë së shtetit vërehet mungesa e sistemit të kamerave me video dhe audio dhe/ose mangësi në dokumentimin e intervistës në ambientet (dhomën e intervistës), kur intervistohen gra dhe vajza të dhunuara. Kjo situatë pengon monitorimin e qëndrimit të policisë ndaj rasteve të denoncimit të dhunës me bazë gjinore.
7. Shqipëria ka një kuadër ligjor relativisht të mjaftueshëm për të dënuar dhunën seksuale ndaj viktimave të mitura dhe të rritura, por problem mbetet zbatimi i tij në praktikë. Ne vërejmë që ka mungesë serioziteti nga autoritetet për trajtimin dhe adresimin e rasteve të dhunës seksuale që ka sjellë si pasojë uljen e besimit të qytetarëve tek policia për të raportuar rastet e dhunës. Legjislacioni ynë penal nuk është në përputhje të plotë me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”, (Konventës Lanzarote) Konventës së Këshillit të Evropës Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventës së Stambollit) dhe rekomandimet e grupit të ekspertëve të kësaj konvente GREVIO. Kështu vepra penale e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dhe të mitura të moshës 14-18 vjec kërkon rezistencë fizike të viktimës dhe në rastin e dhunës ndaj viktimave të mitura lidhet me arritjen e pjekurisë seksuale.
8. Mungon një Plan Kombëtar kundër Dhunës seksuale me drejtimet kryesore të punës, aktorët përgjegjës, buxhete, etj.
9. Mekanizmat e Koordinuar të Referimit (MKR) për të adresuar rastet e dhunës, pranë Bashkive, janë të papërgatitura në lidhje me menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale ndaj vajzave dhe grave. Përfaqësuesit e Drejtorive Arsimore nuk marrin pjesë rregullisht dhe aktivë në takimet e MKR dhe nuk mbajnë përgjegjësi për mos pjesëmarrjen. Ka paqartësi nga ana e tyre mbi rolin që kanë si anëtarë të MKR. Bashkëpunimi i shkollave me anëtarët e MKR nuk ka rezultuar efektiv në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale në mënyrë ndërdisiplinare.
10. Media ka luajtur një rol të rëndësishëm për zbulimin e rasteve dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë ndaj fenomenit shqetësues të dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave. Por nga ana tjetër, disa media kanë publikuar të dhëna personale të rasteve të fundit të viktimave të mitura dhe të rritura të dhunës

seksuale, çka e bëjnë rastin lehtësisht të identifikueshëm dhe, për pasojë, e riviktimizojnë atë.

**Rrjeti vëren se fenomeni shqetësues i dhunës seksuale ndaj vajzave dhe grave kërkon reflektim serioz dhe të thellë nga institucionet shtetërore, i shoqëruar me një plan masash në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afagjatë.**

**I. Në planin afatshkurtër, Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore i rekomandon Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR):**

- a. të krijojë një Task Forcë me përfaqësi multidisiplinare (mësues, psikologë, punonjës socialë, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, organizatat e shoqërisë civile) me qëllim kryerjen e një monitorimi në nivel kombëtar të të gjitha shkollave 9 vjeçare dhe shkollave të mesme, duke filluar nga semestri i ri i vitit që vjen. Objekt i këtij monitorimi mendojmë që duhet të jetë identifikimi i problematikave lidhur me përhapjen e dhunës seksuale ndaj vajzave, mënyrës se si funksionojnë strukturat e brendshme të shkollave, procedurat e ndjekura për rekrutimin e stafëve të sigurisë në shkolla, etj.
- b. të fuqizojë modelin e Shkollës si Qendër Komunitare përmes buxhetimit të tij dhe të krijojë akses për organizatat e certifikuar të shoqërisë civile apo profesionistët e certifikuar për të bërë të mundur trajtimin e temave që kanë të bëjnë me dhunën seksuale, mjetet ligjore dhe mekanizmat ku mund të adresohet, metodat e prindërimit si edhe ku mund të kërkohet ndihmë nëse hasin vështirësi.
- c. të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile dhe të mbështesë kryerjen e një anketimi në nivel kombëtar, me shkollat 9 vjeçare dhe shkollat e mesme se sa nxënësit e njohin dhunën seksuale dhe cili është perceptim i tyre sesa të kërcënuar janë prej saj, potencialisht apo realisht.
- d. të forcojë ofrimin e edukimit seksual gjithëpërfshirës në shkolla për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore dhe asaj seksuale.
- e. të fuqizojë shërbimin psiko social në shkolla përmes rritjes së numrit të psikologëve, punonjësve socialë, përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve psiko sociale. Një strategji për monitorimin e punës së psikologëve në shkolla është shumë e nevojshme.
- f. të përfshijë Punonjësit Social në shkolla dhe të rishikohen profilet e punonjësve që ofrojnë shërbime psiko-sociale në shkolla nëse kanë formimin e duhur profesional dhe etik.
- g. të mundësohet përfshirja në shkolla e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime psiko sociale. Shërbimi psiko social në shkolla të referojë rastet e dhunës seksuale në shërbime publike të tjera ose të organizatave të shoqërisë civile sipas nevojave të rastit.
- h. Të forcojë rolin dhe transparencën e Bordeve të Prindërve dhe Bordeve të Nxënësve në Shkolla, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në

tërësi dhe dhuna seksuale në veçanti.

- i. Të miratojë planin e veprimit “Shkolla të Sigurta për të Mësuar”, punuar nga të gjithë anëtarët dhe partnerët e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri dhe i dorëzuar në MASR.
- j. Të krijojë një poster me sloganë kyç dhe numra telefoni për raportime të nxënësve dhe të sigurojë që drejtoritë e shkollave e mbajnë posterin përgjatë gjithë vitit shkollor.
- k. Të vendosen kamera të sigurisë, sidomos në shkollat e mesme te zonave rurale dhe ndërrurbane, ku edhe vulnerabiliteti i vajzave është më i lartë.

## **II. Në planin afatshkurtër, Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore i rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe/ose Ministrisë së Brendshme:**

- a. të ndërmarrin një plan monitorimesh tematike në bashkëpunim me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat i cili mund të shtrihet në të gjitha strukturat vendore të policisë së shtetit për të supervizuar në një periudhë që përfshin 5 vitet e fundit, cilat kanë qenë kallëzimet lidhur me dhunën seksuale ndaj vajzave të mitura dhe grave dhe si janë trajtuar ato.
- b. Të kryhet një analizë e punës së oficerëve të sigurisë në shkolla dhe trajnim i menjëhershëm i tyre në lidhje me dhunën seksuale dhe identifikimin e saj. Të ngrihet një mekanizëm llogaridhenie ndaj tyre dhe institucioneve përgjegjëse.
- c. të rritet numri i trajnimeve për punonjësit e policisë që mbulojnë krimet seksuale/ trafikimin/ dhunën në familje mbi mënyrën sesi se si duhet të sillen dhe të trajtojnë rastet e dhunës seksuale ndaj vajzave dhe grave si edhe të ndalohet lëvizja e vazhdueshme e kësaj kategorie punonjësish të trajnuar, në struktura të tjera të Policisë së Shtetit. Trajnimet rekomandohet të kenë në qendër viktimën e dhunës seksuale, me pjesëmarrje të sa më shumë punonjësve të policisë së shtetit, në të gjitha nivelet, të jenë specifike, konkrete si dhe të mund të përfshijnë tematika shumë të rëndësishme si: stereotipet, kultura, gjinia dhe seksi, kuadri ligjor/nënligjor, intervistimi me viktimën e dhunës seksuale duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, nevojat/shërbimet për rastin e dhunës seksuale, referimi i rasteve pranë OSHC-ve për mbështetjen dhe riintegrimin e tyre. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të ndjekë formimin në vazhdimësi të punonjësve nëpërmjet programeve të standardizuara trajnuese vjetore të detyrueshme.
- d. të monitorohet rregullisht njohja dhe zbatimi i Procedurave Standarte të Punës në trajtimin e viktimave të krimeve seksuale dhe hetimin e krimeve seksuale nga punonjësit e policisë që mbulojnë këto krime.
- e. të forcohet bashkëpunimi midis punonjësve të policisë dhe MKR-ve në nivel bashkie, për të përmbushur detyrimin e identifikimit dhe referimit të rasteve të dhunës dhe dhënë një shërbim të specializuar pranë këtyre strukturave çdo rasti të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale si edhe rastet e dhunës në familje.

- f. të forcojë punën për identifikimin e rasteve të viktimave të dhunës seksuale dhe refrimin e tyre pranë organizatave të shoqërisë civile për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre.
- g. Të ristrukturohen detyrat e SPZ me fokus vetëm në çështje që lidhen me sigurinë e komunitetit, të analizohet si dhe sa ndikon ngarkesa e punës në parandalimin dhe trajtimin efektiv të rasteve të dhunës në familje si edhe të merren masat e nevojshme.
- h. Të merren masa që viktimat e çdo lloji forme dhune kur denoncon dhunën në polici të mbështetet nga një psikolog/punonjës social. Ky profesionist mund të mos jetë staf i brendshëm i komisarariatit por të njoftohet sa herë është e nevojshme.
- i. të ngrihet brenda Drejtorive Rajonale të Policisë një mekanizëm efektiv për të garantuar ruajtjen e privatësisë dhe anonimatit të viktimave të dhunës seksuale që drejtohen për të denoncuar dhe të shmanget në çdo rast ekspozimi i tyre i panevojshëm.
- j. Të mundësojë monitorimin nga organizatat e shoqërisë civile të rasteve të denoncimit të abuzimeve seksuale në Drejtoritë e Policisë në Qarqe.

**III. I rekomandojmë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të ushtrojë një mbikqyrje parlamentare për zbatimin e legjislacionit që mbron vajzat dhe gratë nga dhuna seksuale.** Në përmbushje të këtij funksioni, i rekomandojmë Kuvendit që me anë të organeve të tij parlamentare të organizojë dëgjesa me përfaqësues të lartë të ekzekutivit, gjyqësorit, prokurorisë, policisë së shtetit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe profesionsitëve të fushës. Në përfundim të këtij procesi dhe analizës së mbështetur edhe në të dhëna statistikore, të marra në rrugë zyrtare, të adresojë çështjet më të rëndësishme dhe rekomandimet që vlejné për të parandaluar dhe adresuar siç duhet këtë fenomen.

#### **IV. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

- a. I rekomandojmë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përgatitjen dhe miratimin e një PLANI KOMBETAR KUNDËR DHUNËS SEKSUALE.
- b. Të përgatitet një raport mbi masat që janë marrë për trajtimin e rasteve të bëra publike, si në drejtim të viktimave të dhunës seksuale ashtu edhe të familjes së viktimave.
- c. të oganizojë fushata informuese (veçanërisht në shkolla) për funksionimin e Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale "LILIUM".
- d. të kryejë trajnime të vazhdueshme (në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile) për anëtarët e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, veçanërisht për adresimin e dhunës seksuale dhe të ketë një plan monitorimi në lidhje me aktivitetin e tyre për menaxhimin e këtyre rasteve.



## V. Ministria e Drejtësisë

- a. I rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë ndërmarrjen e masave të menjëhershme për rishikimin e legjislacionit mbi dhunën seksuale, ushtruar ndaj të miturve dhe viktimave madhore.
- b. Të bashkërendojë punën mes institucioneve në nivel qendror, vendor dhe organizatave të shoqërisë civile në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut dhe Planit të Veprimit.
- c. Të vijojë marrja e masave për krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, në zbatim të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", me qëllim rritjen e aksesit të viktimave të dhunës seksuale në ndihmën juridike falas.

**VI. I rekomandojmë organeve të drejtësisë penale (Prokurorisë dhe Gjykatës), që në përmbushje të misionit të tyre ti kushtojnë rëndësinë maksimale çdo çështje penale që ka të bëjë me dhunën seksuale.** I rekomandojmë prokurorisë të kryejë një hetim të plotë, të thellë dhe të gjithëanshëm për këto raste si dhe të fillojë kryesisht hetimet për çdo rast të sinjalizuar në publik. I rekomandojmë Gjykatës të gjykojë në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm, çdo akuzë që rëndon ndaj një apo më shumë personave për dhunë seksuale, duke vendosur para përgjegjësië penale autorët e këtyre veprave.

## VII. Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA

- a. I rekomandojmë Autoritetit të Mediave Audiovizive AMA dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare AKEP-it që të tregojnë kujdesin e duhur, në ushtrim të kompetencave që parashikohen në legjislacionin në fuqi, ndaj mediave që nuk respektojnë të dhënat personale të viktimave të dhunës seksuale të mitura dhe të rritura. Udhëzues të qartë për raportimin e këtyre rasteve në media nevojiten të bëhen pjesë e trajnimeve të vazhdueshme për mediat.
- b. I rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme ndaj mediave që kanë publikuar të dhënat personale të viktimave dhe vijojnë të shkelin Kodin e Etikës dhe ligjin, jo vetëm përmes gjobave por deri në mbylljen e tyre.

## VIII. Bashkitë

- a. Të ngrihen dhe funksionojnë efektivisht në të gjitha Bashkitë në vend Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje dhe mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve.
- b. Të fuqizohen Mekanizmat e Koordinuar të Referimit në parandalimin e rasteve të dhunës seksuale dhe trajtimin e rasteve të identifikuara.
- c. Të buxhetohen shërbime sociale për viktimat e dhunës seksuale.
- d. Të forcohet roli i punonjësit socialë në njësitë e vetëqeverisjes vendore për organizimin e takimeve informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin mbi temat e dhunës seksuale.

- e. Të fuqizohet struktura e mbrojtjes së fëmijëve dhe të bashkëpunohet me shkollat me qëllim diskutimin mbi çështje të dhunës seksuale ndaj të miturve, raportimit dhe menaxhimit të rasteve.
- f. Të marrin masa për krijimin e Njësive për vlerësimin e nevojave dhe referimin e rasteve në nivel njësie administrative sipas detyrimeve ligjore.

### **IX. Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**

- a. I rekomandojmë Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve që të angazhohet në mënyrë proaktive në problematikat me të cilat përballen të miturit në Shtëpitë e Fëmijës, me fokus të veçantë në fenomenin e dhunës seksuale.
- b. Të bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile për referim dhe asistim të rasteve të të miturve viktimë të dhunës seksuale me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre.

### **X. Urdhri i Psikologut**

Urdhri i Psikologut të kryejë një vlerësim periodik mbi mënyrën se si psikologët e shkollave ushtrojnë kompetencat e tyre dhe trajtojnë rastet e dhunës ndaj të miturve, përfshirë dhunën seksuale.

### **XI. Organizatat e shoqërisë civile do të vijojnë punën e tyre për të:**

- a. Ndërgjegjësuar qytetarët dhe publikun në tërësi për të mos heshtur, por denoncuar dhunën seksuale edhe kur personi nuk është viktimë, duke synuar rritjen e informacionit për dëmet e rënda që ky fenomen shkakton në shëndetin fizik dhe mendor të vajzave dhe grave, të drejtat e tyre si edhe për mekanizmat dhe rrugët ligjore të denoncimit.
- b. Reaguar në mënyrë proaktive dhe monitoruar zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale, duke kryer monitorime në shtëpitë e fëmijës, strukturat vendore të policisë së shtetit dhe organet e drejtësisë.
- c. Ofruar trajnime dhe ngritje kapacitetesh për punonjës që veprojnë në sektorë kyç të parandalimit, trajtimit dhe adresimit të dhunës seksuale si punonjësit e sektorit të arsimit, policisë, bashkisë, drejtësisë, etj.
- d. Ofruar shërbime direkte për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës seksuale, të tilla si shërbime psiko-sociale, ligjore, psiko-sociale si edhe shërbime të tjera sipas nevojave specifike të viktimave të dhunës seksuale. Rritja e aksesit të viktimave të dhunës seksuale nga grupet e marginalizuara, grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në infrastrukturë dhe informacion, grave dhe vajzave romë, komuniteti LGBTI në sistem do të përbëjë një nga drejtimitet e punës së OJF-ve me qëllim rritjen e këtij aksesit dhe garantimin e të drejtave.
- e. Studiuar legjislacionin për mbrojtjen nga dhuna seksuale dhe Kodin Penal me qëllim që të identifikohen dhe adresohen mangësitë, boshllëqet e tij (referuar



në Konventën Lanzarote, Konventën e Stambollit dhe Raportin e GREVIO për Shqipërinë si edhe në raport me standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare) dhe për të lobuar/advokuar me Kuvendin për përmirësimin e tij.

- f. Forcuar urat e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Median, me qëllim që të parandalohet dhe luftohet efektivisht fenomeni i dhunës seksuale si edhe të mbrohen të dhënat personale të viktimave të dhunës seksuale nga media dhe të gjithë aktorët.
- g. Lobuar dhe advokuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Linjës e njësitë e vetëqeverisjes vendore që shërbimet në ndihmë të Fëmijëve dhe grave viktimave të dhunës seksuale në të gjithë vendin të ngrihen dhe buxhetohen.
- h. Monitoruar çdo tre muaj mbi zbatimin e rekomandimeve të sipërpërmendura edhe duke kërkuar informacion në bazë të ligjit;
- i. Lobuar dhe advokuar me autoritetet përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve afatshkurtra, të sipërpërmendura si dhe rekomandimeve afatmesme dhe afatgjata që Rrjeti do të ndaj me ju në vijim.